

Për PRINDËRIT.....

Në rast se fëmijët tuaj kanë morra apo vezë morrash (thërijë) në kokë, ju duhet të mbani mend që:


- **Morri nuk fluturon apo kërcen.**
- **Nuk ka origjinë nga kafshët.**
- **Nuk përzgjedh sipas klasës së shoqërisë.**
- **Prek flokët e pastër ose të pisët.**
- **Gjendet më shpesh në flokët e drejtë.**

Në rast se nuk ka morra ose thërija në kokë nuk është e nevojshme të përdorni produkte të posaçme.

Kur ka morra, mund të keni:

- kruarje
- pluhur i thatë, i zi /gri
- hedhje gri mbi jastëk

SI VEPROHET KUR KA MORRA OSE THËRIJA



1. Shkoni tek mjeku për t`u siguruar
2. Kryeni trajtimin
3. Lajmëroni shkollën, miqtë apo skuadrën e sportit të fëmijës në mënyrë që prindërit e fëmijëve të tjerë mund të kontrollojnë fëmijët e tyre
4. Shkoni sërish tek mjeku për të marrë dokumentin e kthimit në shkollë të fëmijës.

TRAJTIMI I KOKËS

Shkoni në farmaci dhe merrni emulsione apo locione të posaçme që përmbajnë PIRETRINË TË SINERGJIZUAR ose 1% PERMETRINË ose 4% DIMETIKON.

Në rast se morrat apo thërijat nuk hiqen pas një javë, përdorni MALATHON (në rast se fëmija është mbi 6 vjeç)

Për të ndihmuar trajtimin shpëlani kokën me ujë dhe uthull (1 shishe ujë me një gotë uthull vere).



Morrat hiqen me dorë në këtë mënyrë:

- Ndani flokët e lagur dhe të pastër në cullufe të vogla.
- Krihni cullufet që nga rrënja deri tek majat me një krëhër të imët e më pas nga majat tek rrënja.
- Pastroni krëhërin pasi të krihni çdo cullufe.
- Hiqni me gishta thërijat që kanë mbetur ose hiqni çdo fije floku në rast se thërijat nuk hiqen lehtë.

Kjo bëhet çdo 4 ditë së paku për 2 javë deri sa të mos ketw më morra apo thërija.


Nuk është e detyrueshme që të prisni flokët.

Fëmija mund të kthehet në shkollë në momentin kur fillon trajtimin, por duhet të kontrollosh që të mos ketë morra apo thërija.

Duhet që t'i dorëzosh mësueses dokumentin e kthimit në shkollë që të jep mjeku.

PËR TË SHMANGUR KTHIMIN E MORRAVE

- Lani në lavatriçe (60°) apo në pastrim kimik rrobat dhe çarçafët e shtratit që fëmija ka përdorur kur zbulove për morrat dhe thërijat.
- Mbylli të gjitha sendet që nuk mund të lahen në një qese plastike për 2 javë.
- Laj krëhërat dhe furçet me ujë të nxehtë (me 60°) me sapun.
- Pasto mirë mobiljet dhe dyshemenë.



SI MUND TË SHMANGET NGJITJA?

- Fëmijët e tu nuk duhet të shkëmbëjnë sende personale (kapele, shallra, krëhëra)
- Lidhni flokët e gjatë (bisht, gërsheta)
- Laj flokët e fëmijëve 2 herë në javë me një shampo normale.
- Kontrolllo gjatë gjithë javëve flokët e fëmijëve të tu, edhe pse nuk kruhen apo shokët e tij nuk kanë morra (kontrolli duhet të bëhet në vend me shumë dritë apo me lente zmadhuese)
- I tregoni menjëherë mësuesve në rast se fëmija ka morra

